



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 67 Prot

Tiranë, më 18.04 2014

VENDIM Nr. 299, dt. 18.04.2014

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 18.04.2014, mbasi shqyrtoi "Raportin e Grupit të Punës (ASHA, IA, ZAKPA) për Projekt-idenë "Përgatitja e projektit të detajuar dhe dosjes së Tenderit lidhur me punët për Restaurimin dhe Konsolidimin e Manastirit të Shën Marisë Apolloni" - Subjekti "PLANET S.A.",

VENDOSI:

- I. Të miratojë ndryshimet në Projekt-idenë "Përgatitja e projektit të detajuar dhe dosjes së Tenderit lidhur me punët për Restaurimin dhe Konsolidimin e Manastirit të Shën Marisë Apolloni" - Subjekti "PLANET S.A.", rezultat i konsulencës midis Grupit të Punës (ASHA, IA, ZAKPA Apoloni) dhe Subjektit "PLANET S.A., sipas shtojcës bashkëlidhur.
- II. Ndryshimet të reflektohen në Projektin e Zbatimit, i cili do të shqyrtohet në KKA përmarrjen e miratimit final.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETARI I KKA
ARTAN PUTO



AGJENCIJA E
SHERBIMIT
ARKEOLOGJIK

Adresa: Rr. Aleksandër Moisiu, Nr. 76, ish Kinostudio
Tiranë, Shqipëri,
Tel/Fax: 04 2272171
www.asha.gov.al



Shtojë e Vendimit Nr. 299, Datë 18.04.2014 të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë

I. Shtigjet e këmbësorëve

1. Gjerësia e shtigjeve të këmbësorëve të jetë deri në 2m.
2. Shtigjet e këmbësorëve të realizohen mbi kuotën ekzistuese të terrenit pas heqjes së shtresës humusore 5-10 cm dhe nivelimit.

II. Zona e parkimit dhe ambienti i shërbimit

1. Zona e parkimit të realizohet mbi kuotën ekzistuese të terrenit pas heqjes së shtresës humusore 5-10 cm dhe nivelimit.
2. Shtrimi i sipërfaqes së parkimit të bëhet me elementë grilantë beton i varfër.
3. Në sipërfaqen e destinuar për ndërtimin e ambientit të shërbimit, brenda zonës së parkimit, do të realizohet gërmimi në thellësinë maksimale 50 cm, nën mbikëqyrjen arkeologjike të specialistëve të ZAKPA Apolloni.

III. Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit

1. Ndërtimi i dy depove të ujit: pranë kapanoneve të DRKK-së; dhe ndërmjet murit të Manastirit dhe shtëpisë së arkeologëve.
2. Depot do të ndërtohen mbi tokë, në beton arme dhe të veshura me tullë.
3. Shtrimi i tubacioneve të furnizimit me ujë do të kalojë në mes të shtresave të shtigjeve të këmbësorëve dukeshmangur gërmimin.
4. Në rastet e pamundësisë për ta fshehur linjën e furnizimit nën shtigjet e këmbësorëve, do të bëhen gërmime minimale.

IV. Portiku i statujave

1. Restaurim i plotë i Portikut të Statujave
2. Përforcim i themeleve të murit lindor do të kryhet në fazë të veçanta hap pas hapi.
3. Në varësi të situatës, gjatë zbatimit të punimeve, do të përcaktohet edhe thellësia e përforcimit të themeleve.
4. Zbatimi i punimeve do të kryhet nën mbikqyrjen arkeologjike.
5. Në rast gjetjesh arkeologjike do të kërkohet konsulencia shkencore e IA.



SEKRETARI I KKA
ARTAN PUTO